



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KËSHILLI I MINISTARVE

V E N D I M

“PROJEKT”

Nr.....datë.....2009

PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN Nr.
9632, datë 30.10.2006 “ PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës, me propozim të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9632, Datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionin shoqërues që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

SALI BERISHA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKT-LIGJ

Nr.....Date.../...../ 2009

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 9632, datë 30.10.2006 “ PËR
SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Pika 3 e nenit 10 “Subjektet e tatimit mbi biznesin e vogël” riformulohet si më poshtë.

“3. Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet, gjatë vitit fiskal, një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 5.000.000 (pesë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël. Ky nen hyn në fuqi në 1 janar 2010.”

Neni 2

Në nenin 11 “Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël”, pika 1 riformulohet si më poshtë.

“1. Kategoritë minimale të bazës së taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe nivelet treguese të taksës, për çdo kategori, jepen në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Aneksi 5 i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” shfuqizohet.

Në nenin 11 "Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël ", pika 2, fjalia e dytë riformulohet si më poshtë.

"Kategoritë e biznesit paraqiten në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij."

Në nenin 11 "Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël" pika 4, riformulohet.

"4. Niveli tregues i taksës, për çdo kategori biznesi në varësi të qarkullimit vjetor, të ndarë sipas intervaleve prej 1 milion lekësh, duke filluar nga vlera minimale prej 2 milion lekësh, jepen në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. "

Neni 3

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne fletoren zyrtare.

Jozefina TOPALLI

K R Y E T A R E

RELACION

PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 9632, datë 30.10.2006 " PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE", TË NDRYSHUAR

Propozimi i këtij projektligji lidhet me korrektimin në këtë ligj të përcaktimit se kush do të quhet "biznes i vogël" dhe do të jetë subjekt i taksës së biznesit të vogël, në bazë qarkullimit vjetor të realizuar. Me miratimin nga Këshilli i Ministrave të një kufiri të ri minimal për klasifikimin e bizneseve si subjekte me TVSH, nga 8 milion lek në 5 milion lek, është e nevojshme që të ndërhyhet në ligjin për sistemin e taksave vendore, për të përcaktuar se çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet, gjatë vitit fiskal, një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 5.000.000 (pesë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël. (neni 1 i projektligjit)

Neni 2 i projektligj bën rregullimin përkatës në Aneksin 5 të ligjit ekzistues në të cilin jepen kategoritë e biznesit të vogël dhe niveli përkatës i taksës së biznesit të vogël. Ky nen propozon shfuqimin e Anesit 5, në të cilin janë të përfshira edhe subjektet me qarkullim vjetor nga 5 – 8 milion lek, duke u zëvendësuar me një Aneks të ri, Aneksi 1 i pligjt të propozuar, në të cilin bizneset sipas kategorive derivojnë deri në ata me 5 milion lek qarkullim vjetor, si dhe taksat përkatëse të biznesit të vogël.

Po në këtë nen është propozuar shfuqizimi i pikës 4 të nenit 11 të ligjit në të cilin përveç Aneksit 5 që ka shoqëriar këtë ligj, është përcaktuar edhe një formulë për llogaritjen e taksës së biznesit të vogël. Në praktikë, sipas bashkive dhe komunave, kjo formulë llogaritje e taksës nuk ka funksionuar dhe gjithnjë është operuar me taksat fikse të përcaktuara në Aneks. Në bazë të ligjit, është përcaktuar se për bizneset me qarkullim më të madh se 2 milion lekë deri në 8 milionë lekë në vit, detyrimi fiskal tregues është i barabartë me shumën e detyrimit për bizneset me qarkullim deri në 2 milion lekë, shtuar me vlerën që del nga shumëzimi i madhësisë prej 1,5 për qind me vlerën në lekë të mesit të çdo intervali prej 1 milion lekësh, sipas të cilit ndahet intervali i qarkullimit 2-8 milionë lekë, përjashtuar rastet e ambulanteve dhe të transportit, të cilat kanë një mënyrë tjetër taksimi, që tregohet në të Ankesin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji. Duke pasur në konsideratë:

- Historikun e Taksës së Biznesit të Vogël (që prej vitit 1992) ku baza e Taksës deri në vitin 2006 ka qënë një përqindje mbi nivelin e xhiros së parashikuar.
- Shpërndarjen më të drejtë të barrës tatimore në varësi të qarkullimit të realizuar
- Duke pasur parasysh se aneksi 5 i ligjit qartëson dhe specifikon taksën e biznesit të vogël, sipas aktiviteteve, xhiros dhe kategorisë së zonave, vendosja në ligj e koeficientit 1.5 e ka vështirësuar në praktikë zbatimin e kësaj takse dhe për këtë arsye propozohet që në ligjin bazë për taksat vendore, në nenin 11, pika 4, paragrafi i dytë të hiqet.

Sipas këtij projektligji kontigjenti i biznesve me qarkullim vjetor nga 5 – 8 milion lek do të kalojë nën administrimin e administratës qendrore të taksave. Siaps llogaritjeve të përafërta të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ky kontigjent është afërsisht 12 mijë në nivel kombëtar.

Ridvan BODE

MINISTER



Aneks 1: TABELA E TAKSIMIT TË SUBJEKTEVE TË BIZNESIT TE VOGEL

Ne mije lek

KATEGORIA I				
NIVELI TREGUESI TAKSES				
	1	2	3	4
Nr.	Xhiro/Aktivitet	Deri 2000	+ 3.000	+ 4.000
a)	Shitje me pakicë	2.000	-	-
b)	Shitje me shumicë	3.000	4.000	5.000
c)	Prodhim	68	83	98
d)	Shërbime	68	83	98
e)	Profesione të lira	33	70	85
f)	Ambulant	25	63	78
		38	75	90
		8		
KATEGORIA II				
NIVELI TREGUESI TAKSES				
	1	2	3	4
Nr.	Xhiro/Aktivitet	Deri 2000	+ 3.000	+ 4.000
a)	Shitje me pakicë	2.000	-	-
b)	Shitje me shumicë	3.000	4.000	5.000
c)	Prodhim	48	63	78
		48	63	78
		23	60	75

d)	Shërbime	20	43	58	73
e)	Profesione të lira	30	53	68	83
f)	Ambulant	5			

KATEGORIA III

NIVELI TREGUESI TAKSES

	1	2	3	4
Nr.	Xhiro/Aktivitet			
	Deri 2000	2.000	+ 3.000	+ 4.000
a)	Shitje me pakicë	-	-	-
		3.000	4.000	5.000
b)	Shitje me shumicë	45	60	75
c)	Prodhim	45	60	75
d)	Shërbime	43	48	73
e)	Profesione të lira	20	43	58
f)	Ambulant	22	45	60
		5		

KATEGORIA I, II, III

NIVELI TREGUESI TAKSES

Nr.	Xhiro/Aktivitet				
g)	Transport				
1.	Transport pasagjeresh				
	Automjet deri ne 5 vende	17.5	-	-	-
	Automjet 6 - 9 vende	35	-	-	-
	Automjet 10- 25 vende	40	-	-	-
	Automjet 26-42 vende	45	**	-	-
	Automjet mbi 42 vende	48	-	**	**
2.	Transport mallrash				
	Automjet der 2 tone	28	-	-	-
	Automjet 2 - 5 ton	40	-	-	-

	Automjet 5 – 10 ton	48	-	-	-
	Automjet 10-16 ton	50	-	-	-
	Automjet mbi 16 ton	75	-	-	-
3.	Transport Ujor				
	Transport detar brenda vendit	55	-	-	-
	Transport ne liqene bredna vendit	48	-	-	-
	Varka per shetitje	15	-	-	-

Shënim:

Në kategorinë I: Bashkia e Tiranës, Bashkia e Durrësit.

Në kategorinë II: Bashkitë: Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Lushnje, Pogradec, Berat, Lezhë dhe Kavajë.

Në kategorinë III: Të gjitha bashkitë e tjera.

Në komuna niveli tregues i taksës është 50 për qind e nivelit tregues të tij për çdo kategori të rrethit në të cilin ndodhet komuna.

Shënim:

Ambulantë konsiderohen vetëm bizneset pa vend fiks që kanë qarkullim jo më të madh se 2 milionë lekë në vit. Nëse vlerësohet se qarkullimi është më i madh ato klasifikohen në një nga kategoritë e tjera të biznesit dhe taksohen sipas asaj kategorie.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE
MAKROEKONOMIKE DHE FISKALE

Nr ¹²⁴³¹ Prot.

Tiranë, më ^{18/11}.....2009

Për:

Z. Bujar NISHANI
MINISTËR I DREJTËSISË

Z. Dritan PRIFTI
MINISTËR I EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJITIKËS

Z. Lulzim BASHA
MINISTËR I BRENDSHËM

Z. Sokol OLLDASHI
MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT

Subjekti: Kërkohet mendim për një projektligj

Lutem gjeni bashkëlidhur për mendim propozimin e projektligjit "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9632, Datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, lutemi mendimin tuaj në një kohë sa më të shkurtër.

Ridyan BODE



Adresa:
Bul. "Dëshmorët e Kombit", Tiranë
Tel&Fax: +355 4 222920
Website: www.minfin.gov.al